



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, Zona Perendimore

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

Kodi CPV: 90522400-6 - Pastrimi dhe trajtimi i tokës

VLERA E FONDIT LIMIT: 103,862,716 (Njeqind e tre milion e teteqind e gjashtedhjetë e dy mijë e shtateqind e gjashtembedhjetë) leke pa tvsh ose 1,087,909 (një milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntë) Euro.

Në mbështetje të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe të nenit 42, pikat 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Shkodër ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote, si më poshtë:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës në lote lidhet me pamundësinë teknike për realizimin e saj në këtë formë. Referuar preventivit të shërbimit, specifikimeve teknike dhe raportit teknik përkatës, ndarja e kontratës në lote do të kërkonte fragmentimin e territorit të Bashkisë Shkodër në zona të veçanta gjeografike. Bazuar në përvojën e viteve të mëparshme, një praktikë e tillë ka rezultuar joefektive dhe e vështirë për t’u administruar.

Për më tepër, natyra e shërbimit kërkon realizimin e tij nga një operator i vetëm ekonomik, me qëllim garantimin e eficiencës dhe efektivitetit maksimal. Përqendrimi i shërbimit në një operator të vetëm mundëson një organizim më të mirë të punës, si dhe lehtëson ndjeshëm proceset e monitorimit dhe raportimit të të gjitha fazave të realizimit të shërbimit.

Ndarja në lote do të sillte konfuzion dhe mbivendosje përgjegjësish, pasi proceset e pastrimit të rrugëve dhe evadimit të mbetjeve urbane janë të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Fragmentimi i tyre në kontrata të veçanta do të krijonte vështirësi në koordinim, do të cenonte vijueshmërinë e shërbimit dhe do të rriste kostot administrative për autoritetin kontraktor.

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se zhvillimi i procedurës pa ndarje në lote është alternativa më e përshtatshme.

Nga ana tjetër, në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, përcaktohen qëllimet kryesore të këtij ligji, të cilat përfshijnë rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të procedurave të prokurimit publik, sigurimin e përdorimit të drejtë të fondeve publike dhe uljen e kostove procedurale, nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe garantimin e trajtimit të barabartë, integritetit, transparencës dhe besimit publik.

Në përputhje me nenin 42, pikat 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, parashikohet se autoriteti kontraktor duhet, në parim, të ndajë kontratën në lote kur kjo është e mundur. Megjithatë, në rastet kur vendoset zhvillimi i procedurës pa ndarje në lote, autoriteti kontraktor ka detyrimin të argumentojë arsyet përkatëse, të cilat bëhen pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Gjithashtu, legjislacioni në fuqi parashikon mundësinë që operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurat e prokurimit si individë ose në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë, duke mundësuar kështu përmbushjen e kontratave edhe në raste kur ato nuk mund të realizohen nga një operator i vetëm.

Në këtë kuadër, ndarja ose jo e kontratës në lote përbën një vendimmarrje të rëndësishme në fazën paraprake të procedurës, pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes dhe konkurrencës. Ky vendim merret duke vlerësuar elementë të tillë si tregu përkatës, niveli i konkurrencës, vlera e prokurimit, si dhe natyra dhe kompleksiteti i shërbimit.

Në rastin konkret, ndarja në lote do të komplikonte ndjeshëm menaxhimin e kontratës dhe shpërndarjen e përgjegjësisë, duke rrezikuar realizimin me sukses të saj, ndërkohë që shërbimi në thelb paraqet një natyrë të unifikuar.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë mënyrën e organizimit dhe operimit të Bashkisë Shkodër, e cila e menaxhon këtë shërbim përmes një strukture të specializuar dhe të organizuar në nivele të ndryshme, ndarja në lote do të sillte kosto shtesë administrative dhe operative, si dhe do të vështirësonte ndjeshëm monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të kontratës.

Për sa më sipër, arrihet në përfundimin se zhvillimi i procedurës së prokurimit pa ndarje në lote është në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi dhe garanton një përdorim më efikas dhe efektiv të burimeve publike.

PERSONI PËRGJEGJËS PËR PROKURIMIN JERTA DILAVERI